



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 35, datë 28.02.2022

**MBI
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË DHE ZGJERIMIT TË LICENCËS SË
SHOQËRISË “RAIFFEISEN BANK” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21, nenit 377, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Ligji nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, në nenin 377, pika 1, parashikon se: *“Të gjitha subjektet e licencuara në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, vijojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, me kusht që brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtaten me kërkesat e këtij ligji”.*

Për të vijuar veprimtarinë për të cilën është licencuar, banka duhet të përshtatet me kërkesat dhe kushtet e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij.

Shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a., aktualisht, mban licencën nr. 3 datë 25.06.2009 si shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në bursë dhe në tregun me pakicë. Licenca është lëshuar në bazë të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, i shfuqizuar.

Licenca që mban “Raiffesen Bank” sh.a. si shoqëri brokerimi (broker-dealer) për titujt që tregëtohen në bursë dhe tregun me pakicë të R.SH, nga pikëpamja e veprimtarive të lejuara të përcaktuara në Ligjin nr. 62/2020, është e njëjtë me shërbimet e investimit:

- Marrje dhe transmetim urdhërash të klientit;
- Ekzekutim urdhërash; dhe
- Tregtim për llogari të vet.

Shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a mban edhe licencën nr. 6, datë 29.09.2010 si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH. Sipas Ligjit të ri nr. 62/2020, shërbimi i kujdestarisë apo ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve, konsiderohet shërbim ndihmës.

Shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a., ka paraqitur raportin e përshtatshmërisë së veprimtarisë me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr.195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, si dhe ka depozituar kërkesën dhe dokumentacionin për zgjerimin e licencës me qëllim zgjerimin e gamës së instrumenteve financiare që do t’i ofrojë klientëve, si dhe zgjerimin e shërbimeve ndihmëse.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:

V E N D O S I:

1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Raiffeisen Bank” sh.a. sipas kërkesave të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij për:

A. Ofrimin e shërbimeve të investimit në titujt e Qeverisë së R.SH për:

- Marrje dhe transmetim i urdhrave;
- Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve; dhe
- Tregtim për llogari të vet.

B. Ofrimin e shërbimit ndihmës në titujt e Qeverisë së R.SH si:

- Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve

2. Miratimin e zgjerimit të licencës së shoqërisë “Raiffeisen Bank” sh.a për:

A. Instrumentet financiare:

- Titujt e transferueshëm;
- Instrumentet e tregut të parasë;
- Kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- Kontratat e opsioneve (options), kontratat e së ardhmes (futures), marrëveshjet e shkëmbimit (swap), kontratat që paracaktojnë normën e interesit në të ardhmen dhe çdo kontratë tjetër derivative lidhur me tituj, monedha, norma interesi ose kthimi (yields), kuotat e lejuara për çlirim të gazeve serrë ose instrumente të tjera derivative, indekse financiare ose njësi financiare, të cilat mund të shlyhen fizikisht ose me para.

B. Ofrimin e shërbimeve ndihmëse:

- Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve për të gjitha instrumentet financiare të listuar më sipër;
- Dhënia e kredive ose e huave një investitori për t’i dhënë mundësi të kryejë një transaksion me një ose më shumë instrumente financiare, ku shoqëria që jep kredinë ose huanë, ose një subjekt tjetër i lidhur me të, është e përfshirë në transaksion;

- Shërbimet e këmbimit valutor kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj;
- Shërbimet e lidhura me dhënien e angazhimeve për blerjen e titujve.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE